



## MF - 250 MATIFIN 10 STANDARD



PAKETIMI

25 kg



RAPORTI I PERZIERJES

6.5-7.5 L / 25kg



KONSUMI

1.5 kg/m<sup>2</sup>

### Përkufizimi i Produktit

MF-250 MATIFIN 10 STANDARD është një llaç me bazë çimento për suva të hollë i përmirësuar me aditivë specialë që mund të aplikohet me dorë ose me makineri.

### Veçoritë

- Ka fuqi të lartë ngjitime.
- Krijon një sipërfaqe të sheshuar dhe të qëndrueshme.
- Rezistues ndaj cikleve të ngrirje-shkrirjes.
- Mund të zbatohet në trashësi 3 deri në 10mm.
- Lehtësisht i punueshëm.

### Udhëzime për përdorimin e Produktit

- Duhet treguar kujdes që sipërfaqja të jetë e trajtuar dhe të jetë e qëndrueshme në funksion të qëllimit të përdorimit.
- Sipërfaqja duhet të jetë e pastruar nga mbetjet që pengojnë ngjitjen.
- Zonat e shkëputura, plasaritura dhe të thyera duhen riparuar me MATIART.
- Para zbatimit sipërfaqja duhet lagur ose për të marrë një rezultat më të mirë duhet trajtuar me MP-809 ACRYPRIME ose me MP-819 BETO-PRIME. Nëse produkti do të zbatohet mbi punime betoni (të pa-suvatuar) atëherë duhet përdorur patjetër MP-819 BETOPRIME.
- 25 kg MF-250 MATIFIN 10 STANDARD duhet zbratur me ngadalë në 5,5 – 6,0 lt. ujë të pastër dhe duhet përzier derisa të përfitohet një masë homogjene pa tokla. Përzierja duhet bërë me mikser në xhiro të ulëta. Nuk duhet shtuar asnjë aditiv (lëndë shtesë) që nuk është i shkruar në udhëzimin e zbatimit të produktit.

-Llaçi i përgatitur duhet lënë 5-10 minuta për t'u bërë gati për përdorim dhe duhet përzier përsëri 1-2 minuta para zbatimit.

-MF-250 MATIFIN 10 STANDARD duhet zbatuar me mallë çeliku në një dorë me trashësi që nuk duhet të kalojë 10 mm. Për aplikimi më të trasha se 10 mm duhet pritur të kalojë të paktën një ditë.

-Që sipërfaqja të marrë pamjen e fundit duhet lëmuar me sfungjer të lagur.

-Pas aplikimit të produktit sipërfaqja duhet njomur në orare të caktuara për 7 ditë me radhë. Kjo kohëzgjatje mund të shkurtohet në aplikimet që bëhen në muajt e verës dhe mund të zgjatet në muajt e dimrit.

-Llaçi në enë që i ka kaluar koha e përdorimit apo ka zënë cipë duhet hedhur poshtë. Kushte atmosferike të tilla si: temperaturë e lartë, lagështi e ulët, erë mund ta shkurtojnë kohëzgjatjen e punueshmërisë së produktit.

-Pas zbatimit të produktit duart dhe veglat e punës duhen larë me ujë të bollshëm.

### Afati i Ruajtjes

12 muaj kur ruhet në paketimin origjinal të mbyllur në vend të thatë.

### Magazinimi

Ruhet në mjedis të thatë. Mos grumbulloni më shumë se 10 thasë njëra mbi tjetrën.

**SKEDA TEKNIKE** (NË +23°C DHE 50% U.R.)

Forma	Pluhur
Ngjyra	Gri / E Bardhë
Magazinimi	12 muaj nëse ruhet në paketimin original të mbyllur, në një vend të thatë.
Raporti i përzierjes	6.5-7.5 litra ujë / 25 kilogram
Temperatura e aplikimit	(+5°C) - (+35°C)
Densiteti (EN 1015-10)	1500 ± 100 kg/m <sup>3</sup>
Koha e punueshmërisë	≥ 120 min
Konsumi	1.5 Kg /m <sup>2</sup> ( per trashesi 1mm)
Koeficienti I perthithjes kapilare	≤ 0.4 kg/m <sup>2</sup> dk0.5/W1
Substanca të rrezikshme	Shiko SDS